



Financuar nga
Bashkimi Evropian

THIRRJE PËR OFERTIM

PËR

DIZAJNER/KOMPANI DIZAJNI

PËR HARTIMIN/KRIJIMIN E NJË FUSHATE VETËDIJËSUESE SI PJESË E NISMËS “FUQIZIMI I PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË”

TERMAT E REFERENCËS

HYRJE

Pjesëmarrja e grave në politikë në nivelin nacional dhe atë lokal mbetet ende e ulët. Sado që Ligji për Barazi Gjinore (LBGj) siguron përfaqësim të barabartë (50% me 50%) ndërmjet grave dhe burrave në të gjitha nivelet, megjithatë Ligji për Zgjedhjet ende nuk është në përputhje me këtë ligj, e po ashtu dënimet për mos zbatimin e LBGJ-së janë të rralla. Gratë me aftësi të kufizuara, si dhe gratë rome, ashkallike, egjiptiane dhe gorane nuk janë të përfaqësuara fare.

Ndër sfidat kryesore të grave në politikë janë; normat gjinore që presupozojnë se gratë nuk kanë aftësi udhëheqëse; ngurrimi i partive politike për të përfshirë gratë, financim i mangët nga partitë si dhe paraqitje të pakta mediale të grave politikane/kandidate; kufizimet e grave për shkak të përgjegjësisë në shtëpi; si dhe lidhjet e dobëta me votuesit. Për më tepër, gratë kandidate nuk kanë burime financiare për të përmirësuar lidhjen e tyre me votuesit.

Që nga themelimi zyrtar në vitin 2003, Rrejt i Grave të Kosovës (RrGK) ka udhëhequr disa nisma për të mundësuar përfaqësimin e barabartë të grave në procese vendimmarrëse.

Kësaj radhe, si pjesë e nismës “Fuqizimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë”, të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, RrGK kërkon që të kontrakttojë një dizajner apo një kompani të dizajnit për hartimin/krijimin e një fushate vetëdijësuese efektive për t'i inkurajuar qytetarët që të votojnë për më shumë gra në zgjedhjet lokale.

Kjo fushatë do të përfshijë disa materiale promovuese për publikun si dhe do të materiale për rrjete sociale, ashtu siç detajohet në vijim:

QËLLIMI

Qëllimi kryesor i kësaj fushate është që të: 1) rrisë vetëdijen e votuesve rreth rëndësisë që ka votimi i më shumë grave në zgjedhjet lokale, e, 2) angazhimit të grave në procese politike dhe vendimmarrës, sidomos të atyre nga grupet e marginalizuara.

Kjo fushatë vetëdijësuese ka më shumë se një audiencë të vetme, duke përfshirë këtu votuesit, mediat, si dhe qytetarët në përgjithësi. Këto do të diskutohen gjatë takimit në fillim të bashkëpunimit me dizajnerin/kompaninë e dizajnit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë/ JOB REQUIREMENTS AND DELIVERABLES

Materialet që kërkohen janë:

- 10-13 dizajne për rrjete sociale (fotografi dhe tekst) për t'u bërë thirrje qytetarëve që të votojnë për më shumë gra;
- 2 video animacione (gjatësia mesatare e tyre do të jetë 4-6- sekonda);
- 2 dizajne për broshura, të cilat do të rrjedhin nga dizajnet më të mira të rrjeteve sociale;
- Printimi i broshurave, nëse shërbimi ofrohet nga kompania juaj.

Përveç në gjuhën shqipe, disa prej materialeve do të përgatiten/përshtaten edhe në gjuhën angleze dhe atë serbe. RrGK do të sigurojë të gjithë përmbajtjen për këto materiale (do të diskutohet edhe me dizajnerin/kompaninë e dizajnit), përkthimin e materialeve, si dhe do të punojë ngushtë me dizajnerin/kompaninë e përzgjedhur gjatë gjithë procesit të punës. Të gjitha materialet duhet të prodhohen në bashkëpunim të ngushtë me RrGK-në, duke siguruar që dizajnet të jenë në përputhje me misionin dhe vizionin e RrGK-së si dhe të ndjekin rregullat e përcaktuara për dukshmërinë e këtyre materialeve nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë.

Konceptet e dizajnit duhet të jenë origjinale si dhe të respektojnë ligjet e autorësisë.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertës tuaj.

Dizajnerin/kompaninë e dizajnit pritet të fillojë punën brenda pak ditësh pas kësaj thirrje për afatin e ofertës. Kalendari i përafërt do të jetë si më poshtë:

Shpallja e tenderit	1 Shtator 2021
Dorëzimi i tenderit	15 Shtator 2021
Dhënia e tenderit	16 Shtator 2021
Takimi informativ	17 Shtator 2021
Drafti i parë i dorëzimit të materialit	22 Shtator 2021
Materiali final	27 Shtator 2021
Drafti i parë i video animacionit	29 Shtator 2021
Video animacioni final	1 Tetor 2021



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Dorëzimi i Ofertave

Ofertat duhet të përfshijnë 1) një propozim të shkurtër teknik me shembuj dhe/ose ide për kampanjën; 2) një portofolio me punë krahasimore që demonstroi kapacitetet; dhe 3) një propozim financiar, që duhet të dërgohen në procurement@womensnetwork.org më së largu deri më 15 shtator 2021, ora 17:00, me titullin “Fushatë Vetëdijësuese - Zgjedhjet”.

Dizajneri/kompania e dizajnit pritët të fillojë punën vetëm pak ditë pas përfundimit të afatit të kësaj thirrjeje.

Vetëm dizajnerët/kompanitë e dizajnit e suksesshëm do të kontaktohen!



Financuar nga
Bashkimi Evropian



European Women
Lawyers Association
The Voice of Women Lawyers Across Europe